

UDHËZIM
Nr. 23, datë 7.9.2015

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 3.11.2014, “PËR ZBATIMIN E
REGJIMIT TË VEÇANTË TË SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË PRODHUESVE
BUJQËSORË PËR QËLLIME TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 159, paragrafi 2, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, bëhet kjo shtesë:

1. Në pikën 3 të nenit 9 të udhëzimit shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin prej 20% të paraqitur në faturën tatimore të lëshuar sipas këtij neni, nëse nuk provon kryerjen e kompensimit të fermerit nëpërmjet likuidimit të vlerës së faturës nga llogaria bankare e tij në llogarinë bankare të fermerit.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani